

REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA GJIROKASTER



RAPORTI HIDROLOGJIK

FAZA II: PROJEKT ZBATIMI

JANAR 2019

**1. STUDIM-PROJEKTIM 'MASA INXHINIERIKE PER STABILIZIMIN
E RRESHQITJES SE MASES NE KODREN E CFAKES, PRANE RRUGES
NACIONALE GJIROKASTER-KAKAVIJE**

**1.a. STUDIM GJEOLIGO-INXHINIERIK, SHPIME GJEOLOGJIKE+ANALIZA
LABORATORIKE PER OBJEKTIN E MASES NE KODREN E CFAKES, PRANE
RRUGES NACIONALE GJIROKASTER-KAKAVIJE**



PERGATITUR NGA BASHKIMI I OPERATOREVE EKONOMIKE:
SEED CONSULTING JV ATELIER 4 JV T.T-SOIL & EARTHQUAKE CONSULTING

**PROJEKTI: STUDIM-PROJEKTIM MASA INXHINIERIKE PER STABILIZIMIN
E RRESHQITJES SE MASES NE KODREN E CFAKES, PRANE RRUGES
NACIONALE GJIROKASTER-KAKAVIJE**

**RAPORTI HIDROLOGJIK
Faza II – Projekt Zbatimi**



Investitor: BASHKIA GJIROKASTER

Konsulent: BOE "SEED CONSULTING" JV "ATELIER 4" JV "T.T-SOIL & EARTHQUAKE CONSULTING"

Grupi i Projektimit:

Inxh. Hidroteknik:

Redi Struga

Stafi Mbështetës:

Inxh. Hidroteknik:

Arkid Gollosi

PERMBAJTJA

1	HYRJE	4
2	KUSHTET HIDROLOGJIKE EKZISTUESE	5
3	VIZITA NE TERREN.....	10
4	ANALIZA DHE INFORMACIONI EKZISTUES HIDROMETEOROLOGJIK	12
4.1	<i>Morfologjia rajonale dhe Kushtet Klimaterike.....</i>	12
4.2	<i>Temperatura e ajrit.....</i>	13
4.3	<i>Temperaturat Ekstreme te Tokes.....</i>	13
4.4	<i>Reshjet mesatare mujore.....</i>	15
4.5	<i>Lageshtia e ajrit</i>	15
4.6	<i>Diellezimi</i>	16
4.7	<i>Mjegulla</i>	17
4.8	<i>Reshjet e debores.....</i>	17
4.9	<i>Reshjet maksimale dhe llogaritjet Hidrologjike</i>	17
4.10	<i>Kohezgjatja llogaritese e Shiut, Koha e Bashkeardhjes</i>	18
4.11	<i>Intensiteti i Shirave.....</i>	20
4.12	<i>Analiza e Prurjeve maksimale</i>	21
4.13	<i>Kushtet Teknike te projektimit (Siguria e prurjes llogaritese)</i>	21
5	PELLGU UJEMBLEDHES DHE ANALIZA E MUNDESIVE PER KULLIMIN E UJERAVE	23
6	LLOGARITJA HIDRAULIKE E STRUKTURAVE TE KULLIMIT.....	29
6.1	<i>Kunetat (Kanalet)anesore.....</i>	29
	• <i>Llogaritja e prurjes për kunetat anësore.....</i>	29
	• <i>Llogaritja hidraulike e kunetave anësore.....</i>	29
6.2	<i>Kanalet e Skarpateve.....</i>	32
6.3	<i>Tubacionet e Sistemit te Ujerave te Shiut.....</i>	33
	• <i>Llogaritja e prurjes për tubacionet e kanalizimit të ujrave të shiut</i>	33
	• <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të sistemit të kanlizimit të ujrave të shiut</i>	34
6.4	<i>Tubacionet e Sistemit te Ujerave te Perdorura</i>	40
6.5	<i>Tombino</i>	45

LISTA E FIGURAVE

Figura 1 - Pozicioni i Siperfaqes se projektit ne Teritorin e Shqiperise	6
Figura 2 – Lëvizja e ujrave në skarpata	7
Figura 3 – Drejtimi i levizjes se ujrave siperfaqesore në kahun e majtë të perroit	8
Figura 4 – Drejtimi i levizjes se ujrave siperfaqesore në kahun e djathtë të perroit	9
Figura 5 - Pamje nga vija e rreshqitjes	10
Figura 6 - Pamje nga infrastruktura e zonës se rreshqitjes nr. 1	11
Figura 7 - Pamje nga infrastruktura e zonës se rreshqitjes nr. 2	11
Figura 8 : – Temperaturat mesatare mujore te Ajrit – Stacioni Gjirokaster	13
Figura 9 : – Temperatura maksimale absolute ne siperfaqen e tokes – Stacioni Gjirokaster	14
Figura 10 : – Temperatura minimale absolute ne siperfaqen e tokes – Stacioni Gjirokaster.....	14
Figura 11 : - Shperndarja nder-vjetore e reshjeve te shiut - Stacioni Gjirokaster	15
Figura 12 : – Lageshtia relative (%) – Stacioni Gjirokaster	16
Figura 13 : – Kohezgjatja e ndricimit te diellit ne ore – Stacioni Gjirokaster	16
Figura 14 : – Numri mesatar i diteve me mjegull – Stacioni Gjirokaster	17
Figura 15 : – Intensiteti i Reshjeve (mm/min) me kohezgjatje <10 minuta dhe siguri te ndryshme.- Stacioni Gjirokaster	20
Figura 16 - Masat hidroteknike per sistemimin e ujrave rreth zonës së pallatit nr.1	23
Figura 17 - Sistemi i kanalizimeve te ujrave te perdorura Pallati 1	24
Figura 18 - Kalimi i ujrave në rrugën nacionale	24
Figura 19 - Masat hidroteknike per sistemimin e ujrave rreth zonës së pallatit nr.2	25
Figura 20 - Sistemi i kanalizimit te ujrave te perdorura Pallati nr2	26
Figura 21 - Masat hidroteknike per sistemimin e zonës midis dy pallateve	26
Figura 22 - Sistemet e kanaleve në skarpatat e sistemuara me taraca	27
Figura 23 : – Plani i masave hidroteknike dhe strukturore për stabilizimin e rrëshqitjes.....	28
Figura 24 : – Seksioni tërthor i rrjedhës	29
Figura 25 : – Sipërfaqja me e madhe kulluese në kunetë	31
Figura 26 : – Vendorsja dhe ankorimi i materialit Multimat 100	33
Figura 27 : – Tubacioni me i ngarkuar P2-8	34
Figura 28 : – Seksioni tërthor i rrjedhës	35
Figura 29 : – Verifikimi i tobinos	45

LISTA E TABELAVE

Tabela 1 – <i>Temperaturat Mesatare mujore te Ajrit ne °C – Stacioni Gjirokaster</i>	13
Tabela 2 – <i>Temperatura maksimale absolute ne sipërfaqen e tokës – Stacioni Gjirokaster</i>	14
Tabela 3 – <i>Temperatura minimale absolute ne sipërfaqen e tokës – Stacioni Gjirokaster</i>	14
Tabela 4 – <i>Shperndarja nder-vjetore e reshjeve te shiut (mm) - Stacioni Gjirokaster</i>	15
Tabela 5 – <i>Lageshtia Relative – Stacioni Gjirokaster</i>	15
Tabela 6 – <i>Kohezgjatja e ndricimit te diellit ne ore – Stacioni Gjirokaster</i>	16
Tabela 7 – <i>Numri mesatar i diteve me mjegull – Stacioni Gjirokaster</i>	17
Tabela 8 – <i>Reshjet me kohezgjatje dhe siguri te ndryshme.- Stacioni Gjirokaster</i>	18
Tabela 9 – <i>Reshjet ne mm me kohezgjatje <10 minuta dhe siguri te ndryshme.- Stacioni Gjirokaster..</i>	19
Tabela 10 – <i>Intensiteti i Reshjeve (mm/min) me kohezgjatje <10 minuta dhe siguri te ndryshme.- Stacioni Gjirokaster</i>	20
Tabela 11 – <i>Llogaritja hidraulike e kunetës AK2-4</i>	31
Tabela 12 – <i>Llogaritja hidraulike e kanalit kolektor të ujrave të skarpatës së sistemuar</i>	32
Tabela 13 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacionit P2-8</i>	35
Tabela 14 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP1-1</i>	36
Tabela 15 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP1-3</i>	36
Tabela 16 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP1-4</i>	37
Tabela 17 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP1-6</i>	37
Tabela 18 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP2-1</i>	38
Tabela 19 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP2-2</i>	38
Tabela 20 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP2-4</i>	39
Tabela 21 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP2-5</i>	39
Tabela 22 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të shiut aksi AP2-6</i>	40
Tabela 23 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS1-1</i>	41
Tabela 24 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS1-2</i>	42
Tabela 25 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS1-3</i>	42
Tabela 26 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS1-4</i>	43
Tabela 27 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS2-1</i>	43
Tabela 28 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS2-2</i>	44
Tabela 29 – <i>Llogaritja hidraulike e tubacioneve të ujrave të përdorura aksi AS2-4</i>	45

1 HYRJJE

Ky raport është sintezë e studimit të kushteve klimaterike dhe hidrologjike që kanë shërbyer për vlerësimin e të dhënave baze të përdorura për llogaritjet hidraulike të projektit “Stabilizimi i rrëshqitjes në kodrën e Cfakeës”.

Stabilizimi i kësaj rrëshqitje siguron qëndrueshmërinë e objekteve që ndodhen në pjesën e poshtme të kësaj rrëshqitje si dhe parandalon ndonjë dëmtim të mundshëm të objekteve në pjesën e sipërme të lëvizjes.

Në figurën 1.1 jepet pozicioni i sipërfaqes së projektit në territorin e Shqipërisë dhe në rrethin e Gjirokastrës.

Projekti i zbatimit, për stabilizimin e rrëshqitjes në të dy anët e përroit parashikon që të ndërtohen dy rrjeshta me pilota dhe mure betonarme. Njëri rrjesht në formë rame do të jetë në pjesën e sipërme të rrëshqitjes për të mbrojtur banesat kurse tjetri në pjesën e fundit të saj dhe do të shërbejë për të mbajtur tupin e rrëshqitjes.

Nga ana hidraulike është menduar që të sistemohen ujrat e pjesës së sipërme të kodrës në mënyrë që ato të mos derdhen në mënyrë të pakontrolluar në skarpaten ku ka probleme stabiliteti..

2 KUSHTET HIDROLOGJIKE EKZISTUESE

Investigimi i kushteve hidrologjike filloi menjehere pas nenshkrimit te marrveshjes me Konsulentin. Këto investigime përfshijnë:

- Vizita ne terren
- Mbledhja e te dhenave nga studimet ekzistuese, analizave dhe raporteve qe permbajne te dhena hidrologjike, perfshire informacionin mbi ngjarjet e jashtezakonshme
- Metodologjia e llogaritjeve hidrologjike
- Marrja ne konsiderate e problemeve qe lidhen me hartimin ne terren te profileve topografike te rrjedhjes ujore brenda zones se Projektit.

Ne figuren 2 jepet harta e pergjithshme hidrologjike e pellgut ujembledhes qe kontribuon ne rrjedhjen ujore te prroit sezonal qe ndodhet midis dy sipërfaqeve në të cilat janë hasur lëvizjet. Pellgu perfshihet si kufi verior rrugën nacionale, ndersa, si kufi jugor eshte kreshta e kodrës së Cfakës. Siperfaqja e ketij pellgu eshte rreth 1.2 ha. Nuk perjashtohet mundesia e futjes ne kete pellg edhe e nje sasive uji qe vjen nga siperfaqet e tjera si rezultat i sistemimit të drejtimit të ujrave.

Nga pikpamja morfologjike pellgu ka formë standarte dhe mblidhet në tombinon që ndodhet në rrugën nacionale. Ajo që ka ndikuar më shumë në zhvillimin e lëvizjeve të tokës në anët e këtij përroi sezonal janë sipërfaqet ujëmbledhëse fqinje të cilat nuk kanë ndonjë organizim të drejtimit të rrjedhës. Këto sipërfaqe dërgojnë ujin në drjtim të dy skarpatave në anën e majtë dhe të djathtë të përroit sezonal në kodrën e Cfakës. Nga figura e mëposhtme shihet se rrëshqitjet kanë ndodhur jashtë vijës ujëndarëse të përroit.



Figura 1 - Pozicioni i Siperfaqes se projektit ne Teritorin e Shqiperise



Figura 2 – Lëvizja e ujrave në skarpata

Në sipërfaqet ujëmbledhëse fqinje në kahun e majtë dhe të djathtë të përroit që japin kontributin e tyre në këto dy pika shkarkimi janë:

Në krahun e majtë:

- Siperfaqja e taracës së pallatit nr.1
- Sipërfaqja rreth pallatit nr.1
- Një pjesë e ujrave që vijnë nga shtegu i shtruar me beton që nis nga rruga Hasan Xhiku

Një kontribut negativ në përkeqësimin e kushteve të rrëshqitjes në kahun e majtë jep filtrimi i ujit nga gropa septike e përdorur nga banesat e ndryshme.




Figura 3 – Drejtimi i levizjes se ujrave sipërfaqësore në kahun e majtë të perroit

Në krahun e djathtë:

- Sipërfaqja e banesave që janë në krah të rrugës Hasan Xhiku
- Sipërfaqja rreth pallatit nr.2
- Sipërfaqja e tarracës së pallatit nr.2
- Sipërfaqja e rrugës që lidh pallatin nr.2 me rrugën Hasan Xhiku



Figura 4 – Drejtimi i levizjes se ujrave sipërfaqesore në kahun e djathtë të perroit

Pra nga sa më sipër dhe nga vizita në terren e shoqëruar me fotot në vijim duket se zona nuk ka ndonjë infrastrukturë të mirfilltë për sistemimin e lëvizjes së ujrave.

3 VIZITA NE TERREN

Nga ana e konsulentit jane bere disa vizita ne terren per te vleresuar kushtet hidrologjike ne zonen e Projektit. Vemendje e vecante iu kushtua siperfaqes siper rrëshqitjes e cila praktikisht kontribuon me furnizimin e me uje te kësaj zone. Konkretisht ne pjesën e sipërme të kodrës deri në kreshtën e saj ka një sërë banesash. Aktualisht përveç një pjese shumë të vogël në pjesën lindore të kodrës, ujrat e shiut janë të pa drejtuara dhe shpërndahen në rrugë dhe derdhen në faqet e kodrës në mënyrë të pakontrolluar duke kontribuar në përkeqësimin e rrëshqitjes.

Gjithashtu disa nga ndërtesat që ndodhen mbi pjesën e rrëshqitjes, përdorin gropa septike për shkarkimin e ujrave të përdorura. Kjo situatë ndikon negativisht në aktivizimin e rrëshqitjes së dheut pasi shton ujin e filtrimit duke rritur presionin e poreve.

Ne vijim jepen disa foto te bera gjate inspektimeve.



Figura 5- Pamje nga vija e rrëshqitjes



Figura 6- Pamje nga infrastruktura e zonës se rreshqitjes nr. 1




Figura 7- Pamje nga infrastruktura e zonës se rreshqitjes nr. 2

4 ANALIZA DHE INFORMACIONI EKZISTUES HIDROMETEOROLOGJIK

Per te bere nje analize te klimes qe rajonit ku shtrihet projekti jane shfrytezuar matjet e botuar te stacionit me te afert, ai i Gjirokastres i cili pozicionohet ne afersi te ketij me koordinata $40^{\circ} 05' N$ dhe $20^{\circ} 09' E$.

Nga investigimi i te dhenave egzistuese hidrometeorologjike mund te thuhet se monitorimet e botuara nga ish Instituti Hidrometeorologjik i Akademise se Shkencave jane me te plotat dhe me nje baze te shendoshe shkencore. Megjithate ne dy dekadat e fundit te dhena jane mbledhur edhe nga IGJEUM (Instituti i Gjeoshkencave, Energjise, Ujit dhe Mjedisit). Nga ky investigim vihet re se:

- Disponohen te dhena te botuara per matjet e disa parametrave klimatologjike si temperatura e ajrit, ererat, diellzimi, vranesia, lageshtia e ajrit, ngjarjet atmosferike, etj per periudhen 1936-1985.
- Disponohen te dhena per sasine vjetore te reshjeve per stacionet meteorologjik te Gjirokastres per periudhen 1931 – 1965.

4.1 Morfologjia rajonale dhe Kushtet Klimaterike

Zona ne studim ndodhet brenda masivit malor jugor te Shqiperise (Nenzona Mesdhetare Kodrinore Juglindore), si pjese e shpatit lindor te Malit te Gjere. Praktikisht zona eshte pjese e lugines se lumit Drino i cili e ka formuar shtratin e tij ndermjet malit te Gjere dhe Lunxherise. Siperfaqja shtrihet ndermjet kuotave 250-300m mnd.

Nga pikpamja klimatike zona karakterizohet nga nje klime shume specifike, shume te nxehte ne vere dhe shume te ftohte ne dimer. Keshtu qe, reshjet mesatre vjetore jane te rendit 1800 mm ne vit. Praktikisht zona njihet me reshje ekstreme te regjistruara ne teritorin e Shqiperise te cilet vijne kryesisht nga ana perendimore. Jane te njohura rastet kur errerat perndimore te ngarkuara me reshje i shkarkojne ato pothuaj teresisht ne luginen e Drinos, nderkohe faqja perendimore e malit te Gjere nuk ka reshje.

Ne dekadat e fundit reshjet e debores jane nje fenomen i rralle me nje shtrese jo te qendrueshme bore por historikisht zona ka qene e perfshire edhe me shtresa te konsiderueshme bore.

Temperatura minimale absolute luhatet ndermjet -3 dhe -5 °C; vetem ne raste shume te rralla, mund te verehen vlera me te uleta te temperaturave minimale. Periudha me temperature minimale $\leq 0^{\circ} C$ ne siperfaqen e tokes zgjat rreth 30-55 dite.

Era fryn ne pergjithesi ne dy drejtime. Gjate sezonit te ftohte te dimrit, predominon era me drejtim VP-JL, ndersa, ne sezonin e ngrohte ne drejtimin e kundert JL-VP. Shpejtesite maksimale te eres ne kete zone gjate stines se ngrohte tregojne vlerat e 17-20 m/s, ndersa gjate stines se ftohte jane afersisht 25-30 m/s.

4.2 Temperatura e ajrit

Temperatura e Ajrit eshte nje element klimatik i rendesishem, i cili shpreh magnituden e energjise diellore ne afersi te Tokes. Ne tabelen dhe grafikun e meposhtem jepen temperaturat mujore mesatare te matura ne Stacionin e Gjirokastres. Nga keto te dhena mund te verehet se vlerat mesatare maksimale jane arritur ne Gusht (23.9 °C), ndersa vlerat minimale ne Janar (5.2 °C). Vlera mesatare per te gjithë vitin eshte 14.5 °C.

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti
Temp. °C	5.2	6.7	9.5	13.2	17.1	21.3	23.8	23.9	20.6	15.2	10.7	6.7	14.5

Tabela 1– Temperaturat Mesatare mujore te Ajrit ne °C – Stacioni Gjirokastrer




Figura 8: – Temperaturat mesatare mujore te Ajrit – Stacioni Gjirokastrer

4.3 Temperaturat Ekstreme te Tokes

Me poshte jepen maksimumet dhe minimumet absolute te temperatures ne siperfaqe te tokes.

Nga tabela 1.2 rezulton se gjate muajve te veres kemi temperatura te siperfaqes se tokes mbi 60⁰, kjo per arsye te ndikimit te rrezatimit diellor. Temperaturat minimale absolute negative te siperfaqes se tokes shfaqen qe ne muajt e pare te vjeshtes dhe vazhdojne deri ne fund te pranveres. Shumica e minimumeve absolute verehen ne janar dhe shkurt.

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetor e
Temp.Ma x Absolute °	24. 4	33. 7	45. 8	52. 9	63. 8	65. 7	68. 3	68. 1	60. 3	49. 6	40. 4	23. 8	68.3

Tabela 2– Temperatura maksimale absolute ne siperfaqen e tokes – Stacioni Gjirokaster




Figura 9: – Temperatura maksimale absolute ne siperfaqen e tokes – Stacioni Gjirokaster

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Vjetore
Temp.Min Absolute °	- 15.6	- 8.6	- 6.9	-3.6	-0.5	4.9	7.8	6.3	0.0	-2.5	-7.8	- 8.3	-15.6

Tabela 3– Temperatura minimale absolute ne siperfaqen e tokes – Stacioni Gjirokaster




Figura 10: – Temperatura minimale absolute ne siperfaqen e tokes – Stacioni Gjirokaster

4.4 Reshjet mesatare mujore

Reshjet jane nje element i rendesishem ne projektimin e rrugeve, vecanerisht te dhenat mbi intensitetin e reshjeve.

Vlerat mujore te reshjeve per llogaritjen e mesatares vjetore jepen ne Tab. 4, dhe pasohen nga paraqitja grafike respektive e shperndarjes se tyre nder-vjetore.

Nga keto te dhena, mund te shihet se vlerat mesatare maksimale jane verejtur ne muajt e dimrit dhe ato minimale ne muajin Korrik. Vlera mesatare per te gjithë vitin eshte 1708 mm. Shuma vjetore mesatare e diteve me sasi reshjesh me shume se 0.1 mm eshte 135.5 dite .

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti
Reshjet (mm)	234	212	166	104	47	48	16	43	60	176	288	314	1708

Tabela 4 - Shperndarja nder-vjetore e reshjeve te shiut (mm) - Stacioni Gjirokaster




Figura 11: - Shperndarja nder-vjetore e reshjeve te shiut - Stacioni Gjirokaster

4.5 Lageshtia e ajrit

Lageshtia e ajrit eshte gjithashtu nje element meteorologjik i rendesishem qe ndikon ne trafikun rrugor.

Ne tabelen e meposhtme paraqitet shperndarja nder-vjetore e ketij elementi. Nga figura rezulton se vlerat maksimale te lageshtise jane verejtur ne muajt e dimrit (84-85%) dhe vlerat minimale ne muajt e nxehte (54- 62%). Shperndarja nder-vjetore e lageshtise relative eshte paraqitur gjithashtu per stacionin Gjirokaster, nga ku mund te shihet se vlerat e ketij elementi lekunden brenda nje intervali te vogel.

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Viti
Lageshtira Rel. (%)	85	79	73	70	69	62	54	54	66	77	84	84	71

Tabela 5 – Lageshtia Relative – Stacioni Gjirokaster




Figura 12: – Lageshtia relative (%) – Stacioni Gjirokaster

4.6 Diellezimi

Ne tabelen dhe grafikun e meposhtem, jepen vlerat mujore ne ore te kohezgjatjes se ndricimit te diellit per stacionin Gjirokaster. Nga keto te dhena, vihet re se vlerat maksimale te ketij elementi jane verejtur ne Korrik dhe vlerat minimale ne Dhjetor. Ne total, kjo vlere eshte 2434 ore gjate gjithe vitit.

Muajt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
Ore Ndrçimi	97	116	155	197	262	307	358	332	243	180	104	83	2434

Tabela 6– Kohezgjatja e ndricimit te diellit ne ore – Stacioni Gjirokaster




Figura 13: - Kohezgjatja e ndricimit te diellit ne ore – Stacioni Gjirokaster

4.7 Mjegulla

Mjegulla perbehet nga pikeza te vogla uji te cilat mbeten pezull ne ajer dhe nuk mund te shihen me sy te lire. Mjegulla ne pergjithesi ka ngjyre gri dhe ne raste te rrallashikueshmeriamund te arrije ne disametra.

Gjate projektimit te rrugeve eshte e rendesishme te dihet numri i diteve me mjegull dhe kohezgjatja e tyre. Numri i diteve me mjegull ndryshon ne menyre te konsiderueshme nga njeri vend ne tjetrin. Analiza e numrit te diteve me mjegull tregon se nuk ka nje rregull ne shperndarjen e mjegulles ne muaj te ndryshem te vitit. Megjithate, numri i diteve me mjegulleshte me i madh ne fillim te vjeshtes, ne dimer dhe ne fillim te pranveres, pra ne gjysmen e ftohte te vitit. Ne zoneneq po studiohet, numrimesatar i diteve me mjegulleshte 35 dite/vit, me maksimumin ne muajtNentordheDhjetor.

Muaji	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	Shuma
NrMesDite me Mjegull	5.2	2.4	1.5	1.1	1.8	0.9	0.5	0.3	1.2	5.5	7.5	7.1	35

Tabela 7 – Numri mesatar i diteve me mjegull – Stacioni Gjirokaster




Figura 14: – Numri mesatar i diteve me mjegull – Stacioni Gjirokaster

4.8 Reshjet e debores

Reshjet e debores jane tepakta dhe numri i diteve me shtrese debore arrin deri ne 4.8 dite ne vit. Maksimumi I shtreses se bores arrin ne muajin janar me trashesi 20 cm.

4.9 Reshjet maksimale dhe llogaritjet Hidrologjike

Praktikisht reshjet maksimale qe bien ne kete zone jane faktori me i rendesishem hidrologjik per krytjen e llogaritjeve dhe permasimin e strukturave hidrulike per drejtimin e ujrave te shiut mbi pjesen e rreshqitjes. Ne nje numer te madh stacionesh meteorologjik historikisht jane bere matje te reshjeve

24h, por ne disa nga keta stacione jane bere edhe matje te shirave me kohezgjatje me te shkurter duke filluar nga rebeshet 10, 20, 30 minuteshe. Po ashtu egzistojne edhe matje te kryera per reshje me kohezgjatje 1, 2,3,6 dhe 12 oreshe.

Ne nje nga studimet e botuara te Institutit Hidrometeorologjik “Manuali i Shirave Maksimale me siguri te ndryshme”, 1985, jane analizuar keto te dhena dhe jane nxjerre vartesi pergjithesuese te cilat kane sherbyer per pergjithesimin e rezultateve ne te gjithe rajonin e Shqiperise si dhe jane nxjerre edhe varesi te besueshme per percaktimin e sasise se reshjeve me kohe te shkurter per ata stacione qe nuk kane matje te tilla. Ne tabelen 8 jepen reshjet me kohezgjatje te ndryshme nga 10 minuta deri 24 ore, per siguri nga 50% deri ne 0.01%, me perseritje nga 2 deri ne 10.000 vjet.

STACIONI	Koha Ore	PERSERITJA (VITE)									
		2	5	10	20	50	100	200	500	1000	10000
GJIROKASTER	0.17	14	22	27	32	39	44	50	58	64	88
GJIROKASTER	0.33	19	30	37	43	52	59	66	76	85	114
GJIROKASTER	0.5	23	35	44	52	62	70	78	90	100	133
GJIROKASTER	1	32	48	59	69	83	93	104	119	131	174
GJIROKASTER	2	44	65	79	93	111	124	138	158	173	226
GJIROKASTER	6	72	105	127	148	176	196	217	246	268	343
GJIROKASTER	12	99	142	171	199	235	262	289	326	353	447
GJIROKASTER	24	136	193	231	267	314	349	385	431	466	582

Tabela 8 – Reshjet me kohezgjatje dhe siguri te ndryshme.- Stacioni Gjirokaster

4.10 Kohezgjatja llogaritese e Shiut, Koha e Bashkeardhjes

Per rastin konkret, ku siperfaqja e pellgut eshte shume e vogel, me interes do te ishin shirat me kohezgjatje shume te vogel, pra shira me karakter rebeshi. Po ashtu sic dihet ne percaktimin e prurjes qe shkarkohet ne seksionin e fundit te pellgut ujembledhes, nje nga faktoret qe ndikojne eshte intensiteti i shiut, pra sasia e shiut ne njesine e kohes. Prurja ne seksionin qe shqyrtohet merr vleren maksimale kur i gjithe pellgu arrin te kontribuojne ne mbledhjen e ujerave, ose e thene ndryshe kur edhe uji i rene ne piken me te larget vjen ne seksionin qe shqyrtohet. Kjo kohe njihet me termin Koha e Bashkeardhjes ose Koha e Koncentrimit.

Shirat me kohezgjatje sa koha e bashkardhjes japin ne seksionin qe shqyrtohet nje hidrograf te tipit me nje maje te mprehte, ndersa, shirat me kohezgjatje me te madhe se koha e bashkardhjes praktikisht nuk kane vlere piku ose shpesh quhen hidrograve me maje te sheshte.

Ne kete kontekst, percaktimi i kohes se bashkardhjes eshte elementi kryesor ne llogaritjet e prurjes maksimale. Lidhur me kete vazhdimisht ka botime te ndryshme te bera ne vende te ndryshme ne varesi te kushteve specifike qe ka cdo pellg. Ne pergjithesi per pellgje te vogla per percaktimin e kohes se bashkardhjes perdoret formula e Keprich-it.

Sipas formulae se Keprich-it, koha e bashkardhjes llogaritet ne baze te gjatesise dhe pjerrtesise se rrjedhes.

$$T_c = 0.0025 \left(\frac{L}{S}\right)^{\frac{1}{2}}$$

Ku:

T_c - Koha e bashkeardhjes (orë)

L - Gjatesia e rruges (m) qe pershkruan rrjedha nga pika me e larget e pellgut deri ne seksionin qe shqyrtohet

S - Pjerrësia e rrjedhës

Per kushtet konkrete ku gjatesite e pellgjeve jane te rendit deri 0.2 km, dhe disniveli i rendit mbi 25-30m, koha e bashke ardhjes rezulton ne diapazonin nga 1 – 7 minuta.

Sic shihet keto vlera jane me te vogla se 10 minuta, pra jashte diapazonit te te dhenave qe disponohen per reshjet ne stacionin e Gjirokastrës. Per te llogaritur keto vlera eshte bere interpolimi duke perdorur formulën:

$$h_{p,t} = H_{p,24} \left(\frac{t}{24}\right)^n$$

Ku:

$h_{p,t}$ - reshjet ne milimetra, me perseritje p vite ne kohezgjatje t ore

$H_{p,24}$ - reshjet maksimale ditore ne mm

N - koeficient korrelacioni i cili per Gjirokastrën ka rezultuar 0.416

Ne tabelen 9 jepen reshjet qe bien per kohezgjatje me te vogla se 10minuta (0.17 ore). Rreshta e ngjyrosur me te verdhe jane vlerat qe do te perdoren per projektin konkret ne varesi te pellgut apo pjese pellgu qe do te shqyrtohet. Sic shihet per nje ngjarje 1 here ne 100 vjet ne Gjirokastrë ne nje kohezgjatje nga 1 deri 5 minuta mund te bien 13-25 mm shi respektivisht, vlera keto nga me maksimalet ne vendin tone.

STACIONI	Koha Min	PERSERITJA (VITE)									
		2	5	10	20	50	100	200	500	1000	10000
GJIROKASTER	0.90	5	7	8	9	11	12	13	15	16	21
GJIROKASTER	1.00	5	7	8	10	11	13	14	16	17	22
GJIROKASTER	1.2	5	7	9	10	12	14	15	17	19	23
GJIROKASTER	1.5	6	8	10	11	13	15	17	19	20	26
GJIROKASTER	2	6	9	11	13	15	17	19	21	23	29
GJIROKASTER	3	8	11	13	15	18	20	22	25	27	34
GJIROKASTER	5	9	13	16	19	22	25	27	31	34	42
GJIROKASTER	7	11	16	19	22	26	29	32	36	39	49

Tabela 9 – Reshjet ne mm me kohezgjatje <10 minuta dhe siguri te ndryshme.- Stacioni Gjirokastrë

4.11 Intensiteti i Shirave

Intensiteti i shirave do te perdoret ne llogaritjen e prurjes maksimale qe do te kaloje ne seksionin qe shqyrtohet. Per kete arsye ne tabelen 10 jepen intensitet e shiut me perseritje te ndryshme per kohezgjatje te shiut nen 10 minuta. Sic vihet re intesitet e shirave me kete kohezgjatje jane te tejskajshme.

STACIONI	Koha Min	PERSERITJA (VITE)									
		2 Vjet	5	10	20	50	100	200	500	1000	10000
GJIROKASTER	0.90	5	7	9	10	12	14	15	17	18	23
GJIROKASTER	1.00	5	7	8	10	11	13	14	16	17	22
GJIROKASTER	1.20	4	6	7	9	10	11	13	14	15	20
GJIROKASTER	1.50	4	5	7	8	9	10	11	12	14	17
GJIROKASTER	2.00	3	5	6	6	8	8	9	11	11	14
GJIROKASTER	3.00	3	4	4	5	6	7	7	8	9	11
GJIROKASTER	5.00	2	3	3	4	4	5	5	6	7	8
GJIROKASTER	7.00	2	2	3	3	4	4	5	5	6	7

Tabela 10– Intensiteti i Reshjeve (mm/min) me kohezgjatje <10 minuta dhe siguri te ndryshme.-
Stacioni Gjirokaster




Figura 15: – Intensiteti i Reshjeve (mm/min) me kohezgjatje <10 minuta dhe siguri te ndryshme.-
Stacioni Gjirokaster

4.12 Analiza e Prurjeve maksimale

Per llogaritjen e prurjeve maksimale qe formohen ne nje pellg ujembledhes egzistojne shume metoda te grupuara ne tre kategori:

- Metoda e perpunimit statistikor te matjeve te bera ne stacione hidrologjike. Kjo metode ne pergjithesi perdoret per pellgje lumore me stacione te instaluar dhe seri te gjate matjesh.
- Metoda e bazuar ne intensitetet e shiut te matura per stacionin me te afert apo mesataren e reshjeve te regjistruara ne stacionet rreth e rrotull siperfaqes qeshqyrtohet. Ndryshe kjo njihet me emrin Metoda Racionale. Kjo metode perdoret ne rastet kur nuk ka matje hidrologjike. Hidrografi i plotes ne pergjithesi pranohet i tipit trekendesh.
- Metoda qe bazohet ne hidrografin njesi me te dhenat e reshjeve ne stacionin me te afert apo stacionet qe rrethojne siperfaqen ne shqyrtim.

Per siperfaqe te vogla (sipas disa autoreve per $A < 10 \text{ km}^2$), Metoda Racionale është metoda më e njohur për llogaritjen e shkarkimeve maksimale, ne pergjithesi kur kerkohet te njihet vlera e prurjes maksimale dhe forma e hidrografit. Kjo metode përdoret gjerësisht në projektimin e strukturave hidraulike si tombino, kanale te te ujerave te larta uji, etj.

Ne kushtet konkrete te projektit te me pellgje ujembledhes me pak se nje hektare, formula Racionale eshte pranuar per llogaritjet e prurjes maksimale e cila jepet në formën:

$$Q_{max} = 0.28 * \alpha * F * i$$

ku

0.28 - eshte koeficient proporcionaliteti;

α - koeficienti i rrjedhjes që varet nga morfologjia e pellgut, lloji i tokes, pjerresia dhe probabilitetit llogarites P;

F - sipërfaqja e pellgut ujëmbledhës në km^2 ;

i - intensiteti i shiut mm/ore.

Nje nga faktoret me te rendesishem qe ndikojne ne menyre te dukshme ne percaktimin e prurjes maksimale eshte koeficienti i rrjedhjes. Ne rastin konkret per ujerat qe do te rrjedhin ne pjesët e asfaltuara ose të shtruara me beton eshte pranuar nje koeficient $\alpha=0.9$, ndersa per siperfaqen tjetere qe praktikisht eshte e veshur me peme dhe shtresa e tokes eshte e veshur me bar, eshte pranuar nje koeficient 0.4. Ne kete faze te projektimit eshte pranuar nje vlere e peshuar e koeficientit te rrjedhjes e barabaret me 0.65.

4.13 Kushtet Teknike te projektimit (Siguria e prurjes llogaritese)

Duke patur parasysh se sasia e reshjeve per nje stacion te caktuar varet edhe nga perseritja e ngjarjes ne vite (siguria), mund te thuhet se edhe prurja maksimale qe grumbullohet ne nje trase rruge eshte funksion i kesaj sigurie. Sa me e rralle ngjarja aq me e madhe sasia e reshjeve, kjo eshte edhe arsyeja qe ne pergjithesi ne Kushtet Teknike te Projektimit siguria e prurjes llogaritese jepet ne varesi te

faktoreve me perfaqeuses te objektit, rendesise se tij dhe ndikimit qe mund te kete ndertimi i tij ne ambientin perreth.

Tre jane kushtet teknike qe sot perdoren ne Shqiperi, KTP 1978, KTP 2001 dhe rregullorja e projektimit te rrugeve, 2015. Standarte te ndryshem pranojen siguri te ndryshme.

Duke pare edhe rendesine e infrastrukturës që në këtë zonë që nuk është shumë e zhvilluar, në kete studim eshte pranuar nje siguri e reshjeve 2% (1 here në 50 vjet), duke llogaritur prurjen per cdo pellg me vehte dhe per kohen perkatese te bashkeardhjes.

5 PELLGU UJEMBLEDHES DHE ANALIZA E MUNDESIVE PER KULLIMIN E UJERAVE

Për të eliminuar mundësinë e shkarkimit të pakontrolluar të ujrave në skarpatat e kodrës është menduar që ujrata e sipërfaqeve në të cilat ka ndërtesa banimi dhe që ndodhen jashtë pellgut ujmbledhës të përroit të mblidhen dhe të ridrejtohen në përroitin sezonal ose në sisteme kanalizimi të posaçme.

Në kahun e djathtë të rrjedhës, pranë pallatit nr 1 do të ndërtohet një sistem kunetash dhe një rrjet oborri për mbledhjen e ujrave të shiut të terracës së pallatit nr 1. Të dy këto sisteme mblidhen në të njëjtën pusetë dhe me anë të një tubacioni drejtohen për në sistemin e kanalizimit të rrugës nacionale.

Gropa septike e dy familjeve të cilat ndodhen në krah të majtë të pallatit nr 1 do të eliminohet. Për këto banesa do të ndërtohet një sistem kanalizimi i cili do të drejtojë ujrata deri në kanalizimin e rrugës Gjirin Zenebisi.



Figura 16- Masat hidroteknike për sistemimin e ujrave rreth zonës së pallatit nr.1



Figura 17- Sistemi i kanalizimeve te ujrave te perdorura Pallati 1



Figura 18- Kalimi i ujrave në rrugën nacionale

Në anën e djathtë të përroit është menduar që të bëhet shtrimi i sipërfaqes me beton dhe pusetat e sistemit të kanalizimeve të oborrit të përdoren për kullimin e kësaj sipërfaqe. Gjithashtu pjesa e sipërfaqes që ndodhet në anë të rrugës Hasan Xhiku do të mblidhet me anë të një sistemi kunetash të ndërtuar në anë të rrugës që lidh pallatin nr.2 me rrugën Hasan Xhiku. Ujrat më pas do të dërgohen në përrua. Përsa i përket sistemit të kanalizimeve të ujrave të përdorura ato do të mblidhen me anë të një sistemi sistemi të ri kanalizimi. Ky sistem do të mbledh ujrat e përdorura nga të gjitha banesat që ndodhen mbi përroit e zonës siç tregohet në figurën e mëposhtme. Sistemi i kanalizimit të ujrave të ndotura do të lidhet në sistemin e rrugës nacionale Gjirokastrë-Kakavijë.



Figura 19- Masat hidroteknike per sistemimin e ujrave rreth zonës së pallatit nr.2

Pjesa qendrore e shtegu që lidh pallatin nr.1 dhe pallatin nr 2 do të mbledhë ujrat e disa banesave që ndodhen sipër këtij shtegu. Për këtë ky shteg do të mbulohet me një shtresë betoni dhe do të ketë në anë një kunetë me përmasa 30cm x 20cm.




Figura 20- Sistemi i kanalizimit te ujrave te perdorura Pallati nr2



Figura 21- Masat hidroteknike per sistemimin e zonës midis dy pallateve

